



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:142661  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05436432

C.nr.846/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, me bashkëpunëtorin profesional Senad Lokaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.H., a nga fshati ... Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson Qëndrim Zogaj, avokat në Shoqërinë e Avokatëve "SCLR Partners", me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt të padisë: për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, shujtës ditore, kualifikimit shkollor dhe kompensimin punës gjatë fundjavës, me vlerë të kontestit 8,996.42 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, në të cilën prezantoi i autorizuari i paditësit dhe në mungesë të të paditurës, më 22 shkurt 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.H., nga Komuna e Rahovecit dhe DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, që paditësit E.H., nga Komuna e Rahovecit, t'ia paguaj shumat si në vijim:

- Në emër të kompensimit të një page mujore ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit dhe atë për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,859.50 euro,
- Në emër të shtesës në pagë për kualifikim shkollor për periudhën nga muaji dhjetor 2018 e deri në muajin mars 2022, për secilin muaj nga 0.5%, përkatësisht për 40 muaj, t'ia paguaj shumën prej 114.00 euro.
- Në emër të kompensimit të orëve të punës gjatë fundjavës, nga muaji dhjetor 2018 e deri në muajin mars 2022, për 150 ditë pune gjatë fundjavës me 50% të llogaritur në orë, shumën prej 2,227.92 euro.

E në shumën e përgjithshme për të tri kërkesat e lartcekura shumën prej 5,201.42 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 12.07.2022 (data e paraqitjes së padisë) deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 611.50 euro, të gjitha

këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbaramit.

II. REFUZOHET si e pabazuar e kërkesëpadia paditësit E.H., nga Komuna e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të “*Detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, që paditësit të lartcekur në emër të shpenzimeve të shujtës ditore nga 5 euro për 759 ditë pune, t’ia paguajë shumën prej 3,795.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, deri në pagesën definitive*”.

## A r s y e t i m

### Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 12.07.2022, ka parashtruar padi, ku ka theksuar se paditësi ka lidhur kontratë pune për kohë të pacaktuar me Policinë e Kosovës, në pozitën e Zyrtarit Policor që nga data 01.02.2012. Ka shtuar se paditësi më datën 10.06.2022 i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensim të shujtave, pagës shtesë (pagës së trembëdhjetë), kualifikimit shkollor dhe punës në fundjavë dhe nga e paditura ka pranuar përgjigjen në kërkesë, me të cilën kërkesa e tij është refuzuar me arsyetim se e paditura nuk ka mjete buxhetore për të përmbushur këto detyrime ndaj paditësit. Pra, e njëjta nuk ka kontestuar se kërkesa e paditësit është e pabazuar, por vetëm ka theksuar se pamundësia financiare e saj nuk lejon që kërkesa e paditësit të aprovet nga e paditura. I autorizuari i paditësit, me parashtrësën e datës 11.12.2023 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.02.2024, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që ka kërkuar që të detyrohet e paditura, t’ia kompensoj paditësit në emër të kompensimit të shujtës ditore nga 5 euro në ditë për ditët e kaluar në punë, dhe atë në shumën totale prej 3,795.00 euro, në emër të një page mujore ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit t’ia kompensoj për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 shumën prej 2,859.50, në emër të kualifikimit shkollor për diplomë universitar – fakultet 0.5%, për periudhën dhjetor 2018 – mars 2022, shumën prej 114.00 euro, dhe në emër të kompensimit e punës gjatë fundjavës për periudhën nga muaji dhjetor 2018 e deri në muajin mars 2022, t’ia paguaj për 150 ditë pune me 50% të llogaritur në orë, shumën prej 2,227.92 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%.

Gjykata me aktvendimin e datës 11.12.2023 e ka lejuar ndryshimin e padisë konform nenit 257 të LPK-së.

E paditura me datë 26.10.2023, ka parashtruar përgjigje në padi ku ka deklaruar se lidhur me kompensimin e pagës së 13-të dhe shtesave tjera si në kërkesëpadi e kundërshtojnë pasi që kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim dhe detyrim

i të paditurës. E paditura ndaj paditësit të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e Kontratës së Punës e cila konsiderohet ligj për palët. Paditësi do të mund të kompensohej për pagën e 13-të dhe brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare, andaj deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar, që nënkupton se nuk është detyrim për të paditurën. E paditura i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Po ashtu e paditura përmes parashtrësës së datës 07.02.2024, duke u deklaruar lidhur me seancën e caktuar për datën 22.02.2024, ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, andaj ka kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë pretendimeve në padi, duke shtuar se në seancën e datës 11.12.2023 kanë bërë precizimin e kërkesëpadisë në formë të shkruar andaj pas pranimit të ekspertizës financiare lidhur me kërkesën për kompensimin e punës në fundjavë për gjithsej 150 ditë pune në fundjavë respektivisht për 1200 orë pune në fundjavë për periudhën nga muaji dhjetor 2018 deri mars 2022 të përlllogaritura me shtesë prej 50% në orë në përputhje me konstatimin e ekspertit financiar kërkojmë që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shumën prej 2227.92 euro ndërsa shumat tjera që i kemi precizuar në precizimin e kërkesëpadisë të dorëzuar në seancën e dt.11.12.2023 rezultojnë të jenë në përputhje të plotë me konstatimet e ekspertit financiar andaj kërkojmë që të njëjtat të aprovohen siç i kemi precizuar sqarojmë se kamatë vonesën e kemi kërkuar nga data 10.06.2022 sepse e paditura me këtë datë ka lëshuar përgjigjen në kërkesën për kompensim me të cilën ka refuzuar kërkesën e paditësit për kompensim andaj nga kjo datë ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimeve. Nga provat e administruara vërtetohet themelësia e kërkesës së paditësit në veçanti nga formularët e vlerësimit të performancës ku paditësi ka marrë vlerësim të kënaqshëm pastaj nga orari i punës ku vërtetohet edhe kërkesa për kompensim të punës në fundjavë, ndërsa lartësia e kërkesës vërtetohet nga vërtetimi i punësimit, e që përfundimisht është konfirmuar edhe me ekspertizë financiare të administruar si provë, e paditura me asnjë provë materiale nuk ka kontestuar kërkesat e paditësit e për më tepër kërkesat për kompensim të punës në fundjavë nuk e ka kontestuar as verbalisht me asnjë deklaram të saj. Andaj, i ka propozuar gjykatës ta aprovoj kërkesëpadinë ashtu është precizuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar, dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 104.00 euro, për 3 seanca të përfaqësim gjyqësor shumën prej 135.00 euro për secilën, për ekspertizës financiare shumën prej 150.00 euro, për taksë gjyqësore për padi shumën prej 61.00 euro apo në total në emër të shpenzimeve t'ia kompensoj shumën prej 720.00 euro.

- Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Përgjigja në kërkesën për kompensim, me numër 07-1-01SAP-p/4752; Kërkesa me numër prot. 5659, e datës 10.06.2022; Vërtetimi i punësimit numër 04/01-08SRR-NJBNJ-228/2022, e datës 18.03.2022; Kontrata e punës nr.ref. 07/1-01r/397/2014, e datës 27.11.2014; Formularët e vlerësimit të performancës, për periudhën 2018-2022; si dhe Vërtetimi për ditët e pranisë në punë, për periudhën dhjetor 2018 – mars 2022; Lista e pagave për muajt Dhjetor për vitet 2018,

2019, 2020, 2021, dhe 2022; Emaili i të paditurës-Sektorit Rajonal për Resurse i dt.13.12.2023 me të cilin e-maili paditësit i janë dërguar listat e pagave për muajt e lartë cekuar; Diploma universitare e datës 10 tetor 2011; Ekspertiza nga lëmia e financiare, e datës 03.01.2024, si dhe dëgjimi i ekspertit financiar N.O.,

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nga kërkesa me numër prot. 5659, e datës 10.06.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi përmes të autorizuarit të tij i është drejtuar të tani të paditurës, për kompensimin e shujtës, pagës shtesë, kualifikimit shkollor dhe punës në fundjavë.

Nga Përgjigja e të paditurës me numër 07-1-01SAP-p/4752, vërtetohet se paditësit iu është refuzuar kërkesa për kompensimin e shujtave, pagave të trembëdhjetë dhe punës në fundjavë.

Nga Vërtetimi i punësimit numër 04/01-08SRR-NJBNJ-228/2022, e datës 18.03.2022, provohet se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 01.02.2012, dhe se paga momentale është 571.90 euro për një muaj kalendarik.

Nga formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës përkatësisht personat kompetent për vlerësim, vërtetohet se i njëjti ka marrë vlerësim shumë të mirë dhe nuk i është shqiptuar ndonjë vërejtje për periudhën kontestuese.

Nga Vërtetimi për ditët e pranisë në punë, për periudhën dhjetor 2018 – mars 2022, vërtetohet se paditësi për periudhën dhjetor janar-dhjetor 2018, ka punuar gjithsej 21 ditë pune dhe 2 ditë punë në fundjavë, në periudhën janar-dhjetor 2019, ka punuar gjithsej 214 ditë pune dhe 36 ditë pune në fundjavë, në periudhën janar-dhjetor 2020, ka punuar gjithsej 253 ditë pune dhe 65 ditë pune në fundjavë, në periudhën janar-dhjetor 2021, ka punuar gjithsej 228 ditë pune dhe 39 ditë punë në fundjavë, në periudhën janar-mars 2022, ka punuar gjithsej 43 ditë pune dhe 8 ditë pune në fundjavë.

Nga Kontrata e punës nr.ref. 07/1-01r/397/2014, e datës 27.11.2014, vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën.

Nga formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës përkatësisht personat kompetent për vlerësim, vërtetohet se i njëjti ka marrë vlerësim shumë të mirë dhe nuk i është shqiptuar ndonjë vërejtje për periudhën kontestuese.

Diploma e Fakultetit me Nr.1233 të datës 26.05.2011, vërtetohet se paditësit ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Fakultetin Juridik dhe ka marrë titullin Bachelor i Drejtësisë.

Listat e pagave për paditësin për periudhën – muajt dhjetor të viteve 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka vërtetuar se paga bazë e paditësit ka qenë sipas grupit PK-301.46/1.

Nga Email-at e të paditurës të datës 13.12.2023, gjykata ka vërtetuar se paditësi i është drejtuar me e-mail të paditurës për t’ia siguruar listat e pagave për muajt dhjetor 2018, dhjetor 2019, dhjetor 2020, dhjetor 2021 si dhe dhjetor 2022, ndërsa e paditura ia ka përcjellur pasqyrat e pagave të kërkuara.

Nga Ekspertiza nga lëmia e financiare, e datës 03.01.2024, të përpiluar nga eksperti financiar N.O., gjykata ka vërtetuar se paditësit në emër të kompensimit të shujtës ditore për ditët e prezencës në punë nga viti 2018 e deri në mars 2022, do të mirren 5 euro në ditë të kaluara në vendin e punës dhe atë për 759 ditë pune, i bie totali për pagesë 3,795.00 euro, në emër të kompensimit të pagesës së një page mujore ekuivalente me pagën mujore të fundvitit 571.90 euro, për periudhën nga vitit 2018 e deri në vitin 2022, shumën prej 2,859.50 euro, në emër të kompensimit të orëve të punës gjatë fundjavës, dhe atë për 150 ditë pune të përllogaritura me 50% orën, i bie për vitin 2018 shuma prej 27.20 euro, për vitin 2019 shuma prej 576.00 euro, për vitin 2020 shuma prej 878.80 euro, për vitin 2021 shuma prej 586.56 euro, për periudhën deri në mars 2022 shuma prej 159.36 euro, në total shuma prej 2,227.92 euro. Ndërsa, në emër të kompensimit për shtesat në pagë për kualifikim shkollor për diplomë universitare – fakultet (571.90 euro \* 0.5% = 2,85 euro), për 40 paga shuma totale prej 114.00 euro.

Eksperti financiar N.O., në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ekspertizës së datës 03.01.2024 të përpiluar me shkrim në lëndën me numër Cnr.846/22 në cilësinë e ekspertit financiar ku detyrat më janë dhanë me vendimin e datës 19.12.2023. Mendimin të dhënë me ekspertizën e përpiluar me shkrim e kam bazuar në shkresat e lëndës që më janë ofruar ku në lidhur me kërkesën për kompensimin e shujtave ditore kam ardhë në përfundim se i njëjti ka punuar 759 ditë pune me e përllogaritur me çmimin 5 euro në ditë nga ka arritur shuma 3,795 euro, për pagën e 13 për vitet e kërkuara kam përllogaritur pagën mujore që ka qenë në lartësi prej 571.9 dhe totali i kësaj kërkesa ka rezultuar 2,859.5 euro, ndërsa në emër të kompensimit të orëve të punës gjatë fundjavës kam analizuar ditët e punës dhe në bazë të kësaj kam ardhur në përfundim që për 150 ditë pune gjatë fundjavës me 50% përllogaritur në orë nga viti 2018 deri Mars 2022 ka rezultuar shuma prej 227.92 euro, dhe në emër të kualifikimit shkollorë për diplomë universitare për 40 paga në shumë totale prej 114 euro, Në shumën totale për katër kërkesat 8,996.42 euro. Po ashtu e njofton gjykatën se në përpilimin e ekspertizës gabimisht e kam shënuar mbiemrin ....., pasi mbiemri është E.H.,

Për gjykatën eksperti në fjalë dhe në këtë lartësi është e pranuar për arsye se eksperti financiar ka dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe profesionale.

- Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i Gjykatës

Sa i përket kërkesës lidhur me kompensimin pagës së trembëdhjetë, gjykata gjen se në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (tutje: UA nr.02/2018) i cili ka hy në fuqi me datë 18.11.2018, andaj me kujdes analizoi dispozitën e nenit 29 paragrafin 2 të këtij UA, ku është përcaktuar se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”* si dhe dispozitat e nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”*.

Lidhur me këtë, gjykata në këtë çështje kontestimore ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur vlerësim plotësisht të kënaqshëm të performancës gjatë viteve 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 dhe të njëjtit në këtë periudhë kohore nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, fakt i vërtetuar përmes formularëve të vlerësimit të performancës që gjenden në shkresat e lëndës. Për më tepër e paditura me anë të përgjigjes në padi nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje që do të vinte në dyshim performancës e paditëses për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit. Në anën tjetër e paditura nuk ka provuar se për këtë kategori të kompensimit, nuk ka pasur mjete buxhetore, gjë që bazuar në nenin 7 të LPK-së ku thuhet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, barra e të provuarit ka rënë mbi të paditurës. Prandaj nga dispozita e lartcekur, rrjedh edhe e drejta e paditëses dhe detyrimi i të paditurës, që pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë dispozitë në fund të një viti kalendarik, paditësi të përfitojë si shpërblim një pagë mujore e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, andaj gjykata pasi vërtetoi edhe lartësinë e pagës mujore të paditëses përmes vërtetimi të punësimit me numër 04/01-08SRR-NJBNJ-228/2022, e datës 18.03.2022, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa, kompensimit në emër të kualifikimit shkollor, i takon duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 3 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Shtesat në pagë për kualifikimin shkollor janë si në vijim: 3.1. diplomë universitare (bachelor, fakultet) 0.5%.”*, dhe nenin 30 paragrafin 3 të UA Nr.01/2021, ku përcaktohet se: *“Shtesat në pagë për kualifikimin shkollor janë si në vijim: 3.1. diplomë universitare (bachelor, fakultet) 0.5%.”*, andaj gjykata ka gjetur se paditësit i takon kompensimi nga muaji dhjetor 2018 e deri në muajin mars 2022, për 40 muaj, në shumën e përgjithshme prej 114.00 euro, pasi që i njëjti ka diplomë dhe ka marrë titullin Bachelor i Drejtësisë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës *“Hasan Prishtina”*.

Sa i përket kompensimit në emër të punës gjatë fundjavës, e njëjta i takon duke u bazuar në nenin 65 paragrafi 1 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Për ditët e punuara gjatë festave pushimeve, punës jashtë orarit, paraqitjes në gjyq, stërvitjeve të obligueshme dhe për kryerjen e detyrave*

*speciale përtej orarit të zakonshëm të punës, bëhet kompensimi në ditë të lira apo në paga shtesë në përqindje të mëditjes” pika 1.5 “50% në orë për punë jashtë orarit” dhe nenin nenin 65 paragrafi 1 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: “Për ditët e punuara gjatë festave pushimeve, punës jashtë orarit, paraqitjes në gjyq, stërvitjeve të obligueshme dhe për kryerjen e detyrave speciale përtej orarit të zakonshëm të punës, bëhet kompensimi në ditë të lira apo në paga shtesë në përqindje të mëditjes”, pika 1.5 “50% në orë për punë jashtë orarit”, andaj gjykata ka gjetur se paditësit i takon kompensimi nga muaji dhjetor 2018 e deri në muajin mars 2022, për 150 ditë pune gjatë fundjavës me 50% të llogaritur në orë, shumën prej 2,227.92 euro, ashtu siç është llogaritur edhe në ekspertizën financiare të datës 03.01.2024.*

Andaj paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, e bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit të ja kompensoi shumat e gjykuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkesës lidhur me kompensimin e shpenzimeve të shujtës ditore, gjykata të njëjtën kërkesë e refuzoi në tërësi, pasi që me kujdes analizoi nenin 29 par.1 të UA nr.02/2018, ku është përcaktuar se “Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, kjo dispozitë nuk e detyron shprehimisht të paditurën në kompensimin e shujtave ditore, por është dispozitë që përcakton kushtet e përgjithshme për përcaktimin e pagës bazë dhe shtesave, e që këto kushte konsistojnë në vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës. Po ashtu, bazuar edhe në nenin 47 par.4 të Ligjit për Policinë numër 04/L-076 është përcaktuar se “Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj.”, e në rastin konkret gjykata nuk gjeti se kompensimi për shujta është i përcaktuar shprehimisht me ligj, pra nuk ka ndonjë dispozitë të karakterit obligativ dhe gjithashtu nuk gjeti se në mes të palëve ndërgjyqëse ekziston ndonjë raport kontraktual që do ta detyronte të paditurën në kompensimin e shujtave ditore për paditësen, për çka rrjedhimisht gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, për faktin se e paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore. Kjo gjykatë vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të te paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim

edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, për të cilat as nuk ka ofruar prova, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, ashtu që u vendos që përllogaritja e kamatës të bëhet nga data 12.07.2022, dita kur është parashtruar kërkesa tek e paditura, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësit ju pranuan shpenzimet në shumë prej 611.50 euro, dhe atë për përpilim të padisë, shumën prej 104.00 euro, për dy (2) seanca të mbajtura të përfaqësimit gjyqësorë, secilën nga 135.00 euro, dhe një (1) seancë të shtyrë, shumën prej 67.50 euro, përllogaritur sipas TAO-se, për ekspertizën financiare shumën prej 150.00 euro, si dhe taksën gjyqësore për padi në shumën prej 20.00 euro. Nuk iu pranua shuma prej ndërsa 108.50 euro, e cila referohet vlerës prej 40, 00 për takse gjyqësore për faktin se nga fletëpagesa e taksës shihet e njëjti ka paguar taksën gjyqësore prej 20,00 euro, si dhe ne emër të përfaqësimit në një seance nuk iu pranua shuma prej 67.50 euro për faktin se e njëjta seance nuk ishte mbajtur por që ishte shtyre pa fajin e palës paditëse.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.846/22, më 22 shkurt 2024

G j y q t a r j a  
Mirjeta Shala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.



Numri i lëndës: 2022:142661  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05436432